



# **BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT**

KORRIK 2024

# BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHETIT

KORRIK 2024

Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen  
aktivitetet e ZKPSH-së për muajin KORRIK 2024

## U.D. Kryeprokurori Kelmendi dhe Ambasadori De Riu diskutojnë për avancimin e bashkëpunimit në fushën e sundimit të ligjit

*Prishtinë, 3 korrik 2024 –*

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka pritur në takim Ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, shkëlqesinë e tij, Antonello De Riu.



Nxitja e bashkëpunimit bilateral ndërmjet institucioneve të drejtësisë italiane dhe asaj kosovare në shkëmbimin e praktikave të ndërsjella në luftimin e të gjitha formave të krimit, konsolidimi i pavarësisë së sistemit prokurorial, gjetja e modaliteteve të bashkëveprimit në ngritjen e kapaciteteve profesionale të Prokurorit të Shtetit përmes programeve dhe projekteve të ndryshme në fushën e drejtësisë penale nga shteti italian, si dhe sfidat e zbatimit të procesit të reformës në drejtësi shin disa nga çështjet thelbësore të cilat u diskutuan në takimin e përbashkët ndërmjet U.D. Kryeprokurorit të Shtetit dhe Ambasadorit Italian.



Në këtë kontekst, palët u pajtuan që të avancojnë bashkëpunimin e ndërsjellë që ka për synim forcimin e sundimit të ligjit dhe luftimin sa më efektiv të krimit.

Në fund, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka falënderuar Ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, shkëlqesinë e tij, Antonello De Riu, për interesimin, mbështetjen dhe përkrahjen që shteti italian e ka dhënë dhe vazhdon ta jep në forma dhe mënyra të ndryshme për institucionin e Prokurorit të Shtetit.

**Urimi i U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, drejtuar Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkëlqesisë së tij, z. Jeffrey M. Hovenier**

#### **4 korrik 2024**

Shkëlqesia Juaj, Ambasador Hovenier,

Me lejon që në emër të institucionit të Prokurorit të Shtetit t'iu përcjellë urimet më ngrohta për Ju, stafin e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë dhe tërë popullin amerikan për Ditën e Pavarësisë.

Deri sa shënoni 248 vjetorin e miratimit të Deklaratës së Pavarësisë, ne në Kosovë festojmë dhe vlerësojmë miqësinë dhe partneritetin tonë të qëndrueshme dhe të përjetshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Bashkë me Ju, sot festojnë të gjitha kombet dhe individët që besojnë në vlerat themelore të demokracisë të cilat e kanë përcaktuar Amerikën.

Republika e Kosovës dhe institucionet e sajë, veçanërisht ato të drejtësisë, vlerësojnë lartë përkrahjen dhe ndihmën e vazhdueshme që shteti dhe populli amerikan e ka dhënë dhe vazhdon ta japë për fuqizimin e institucioneve të forta dhe stabile të cilat kontribuojnë në forcimin e sundimit të ligjit dhe ecjen përpara të shtetit tonë drejt integriteteve perëndimore.

Ne jemi krenarë për lidhjet e forta midis popujve dhe institucioneve tona dhe, mirëpresim që partneriteti dhe bashkëpunimi ynë të jetë i përhershëm.

*Sinqerisht,*

**Besim Kelmendi**

**U.D. Kryeprokuror i Shtetit**



**U.D. Kryeprokurori Kelmendi vlerësoi angazhimin e Këshilltarit Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane, John C. Hanley, në fuqizimin e institucioneve të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës**

**Prishtinë, 10 korrik 2024 –**

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, priti në takim lamtumirës Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë, z. John Hanley, i cili në këtë takim është shoqëruar nga Këshilltari Rezident Ligjor, z. Erin Cox dhe Këshilltari i Lartë Ligjor në OPDAT, z. Etrur Maloku.



Me këtë rast, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka vlerësuar lart angazhimin dhe kontributin profesional të z. Hanley që ka dhënë në forma të

ndryshme për institucionet e drejtësisë, veçanërisht për Prokurorin e Shtetit në ngritjen e kapaciteteve profesionale, duke ndihmuar në fuqizimin e integritetit institucional dhe forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



Në fund të takimit, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, në shenjë respekti dhe falënderimi i ka dhënë Këshilltarit Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë, z. John Hanley, stemën e Prokurorit të Shtetit, me ç'rast i ka dëshiruar suksese në angazhimet e reja profesionale.

### **Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve zhvilloi takim pune me zyrtarët e deleguar nga institucionet ligj zbatuese në këtë zyrë**

#### **Prishtinë, 12 korrik 2024 –**

Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve - Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Bahri Hyseni, së bashku me zyrtarët e deleguar nga institucionet ligj zbatuese në këtë zyrë, mbajtën takim pune. Në këtë takim morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtar që e mbështesin punën e kësaj zyreje.

Gjatë këtij takimi u diskutua për finalizimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Zyrën për Rikthimin e Aseteve, konkretisht janë finalizuar për secilin institucion përshkrimet dhe përgjegjësitë, të cilat dalin me Rregulloren për Themelimin e Zyrës për Rikthim të Aseteve dhe nënshkrimin të memorandumit për funksionalizimin e kësaj Zyreje.



Këto procedura standarde të veprimit, të cilat janë hartuar në përputhje me dokumentet dhe standardet e BE-së për rikthimin e asetëve do të jenë ndihmesë për të gjithë prokurorët që kanë nevojë për ndihmën e Zyrës për Rikthim të Aseteve.

### **U.D. Kryeprokurori Kelmendi së bashku me Kryesuesin Hajdaraj pritë në takim Drejtorin e Akademisë së të Drejtës Evropiane (ERA), z. Jean-Philippe**

#### **Prishtinë, 15 korrik 2024 –**

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi së bashku me Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Ardian Hajdaraj dhe me Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, z. Enver Fejzullahu, pritë në takim Drejtorin e Akademisë së të Drejtës Evropiane (ERA), z. Jean-Philippe, me bashkëpunëtorë.



Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe për

intensifikimin e aktiviteteve të Akademisë së të Drejtës Evropiane, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të sistemit prokurorial për zbatimin e të drejtës së BE-së.

Fillimisht, Kryesuesi Hajdaraj ka njoftuar z. Jean-Philippe për nevojat e sistemit prokurorial në fushën e ngritjes së kapaciteteve profesionale, duke theksuar se sistemi prokurorial përbëhet nga prokurorë të rinj dhe se janë të mirëpritura trajnimet specifike, sidomos ato që ndërlidhen me temat e luftimit efikas të korrupsionit, shpëlarjes së parasë, krimeve kibernetike dhe krimit të organizuar.



Gjatë diskutimeve të është kërkuar që në trajnimet online që organizohen nga ERA të marrin pjesë prokurorët dhe, njëkohësisht, të shfrytëzohen materialet trajnuese që publikohen në uebfaqen e kësaj akademie evropiane.

Programet e Akademisë së të Drejtës Evropiane (ERA) ndihmojnë vendet e Ballkanit Perëndimor me trajnime për rritjen e kapaciteteve, duke aftësuar dhe përgatitur prokurorët dhe gjyqtarët e vendeve rajonale në zbatimin e së drejtës së BE-së.

**U.D. Kryeprokurori i Shtetit vizitoi depon e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar**

**Prishtinë, 17 Korrik 2024 –**

Me ftesë të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, z. Shqipdon Fazliu, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, së bashku me anëtarët e Këshillit

Prokurorial të Kosovës (KPK), prokurorë të ZKPSH-së, anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe përfaqësues të institucioneve tjera ligjzbatuese si dhe Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë, z. Erin Cox, gjatë ditës së sotme kanë vizituar depon e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK).



Qëllimi i kësaj vizite ishte për të parë nga afër punën dhe funksionimin e kësaj agjencie në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar të cilat janë përdorur për kryerjen e veprave të ndryshme penale apo janë përfituar nga vepra penale.

Më këtë rast, përfaqësuesit e institucioneve respektive kanë zhvilluar diskutime të përbashkëta mbi gjetjet në terren (depo) dhe hapat e ardhshëm që duhet ndërmarrë lidhur me pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara që gjenden në administrimin e AAPSK-së.

**Mesazhi i U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Drejtësisë Penale**

**Prishtinë, 17 Korrik 2024 –**

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare,

Të nderuar përfaqësues të mediave dhe organizatave të shoqërisë civile,

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Drejtësisë Penale, dëshiroj të konfirmoj angazhimin institucional të Prokurorit të Shtetit në luftimin efektiv të të gjitha formave të krimit dhe forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Gjatë punës tonë të përditshme në hetimin, ndjekjen dhe vënien para drejtësisë të personave që kanë kryer vepra penale, Prokurori i Shtetit siguron trajtim të barabartë dhe objektiv për të gjithë personat pa diskriminim në baza kombëtare, religjioze, gjinore, racore, bindjeve politike apo pozitës shoqërore.

Prokurori i Shtetit është i pavarur dhe i paanshëm gjatë ushtrimit të funksionit të vet, duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet vendore, konventat ndërkombëtare dhe standardet më të larta të së drejtës pozitive.



Mbajtja përgjegjës dhe llogaridhënës e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale, mbrojtja e viktimave të krimit, fuqizimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në fushën penale, avancimi i parimit të llogaridhënies dhe rritja e besimit të publikut nëpërmjet ngritjes së transparencës institucionale janë objektivat kryesore të punës dhe angazhimit të Prokurorit të Shtetit gjatë realizimit të mandatit kushtetues dhe ligjor.

Në frymën e kësaj, Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me të gjithë partnerët ndërkombëtarë për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

**Besim Kelmendi**

**U.D. Kryeprokuror i Shtetit**

## Nënshkruhen Procedurat Standarde të Veprimit të Zyrës për Rikthim të Aseteve

**Prishtinë, 24 Korrik 2024 –**

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi në prezencë të Udhëheqësit të Zyrës për Rikthim të Aseteve, prokurorit të shtetit z. Bahri Hyseni dhe përfaqësuesëve të institucioneve ligjzbatuese që janë pjesë e kësaj zyre si Policia e Kosovës, Njësi të Inteligjencë Financiare, Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Konfiskuara dhe të Sekuestruara, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës kanë nënshkruar sot Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Rikthim të Aseteve, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.



Me këtë rast Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, theksoi se me nënshkrimin e këtyre procedurave po kompletohet infrastruktura ligjore për funksionimin e plotë të Zyrës për Rikthim të Aseteve, procedura këto që do t'u shërbejnë të gjithë prokurorëve në rastet kur ka vend për rikthim të asetëve.



Procedurat Standarde të Veprimit përshkruajnë mënyrat dhe procedurat që duhet të ndiqen për

funksionimin sa më efikas të Zyrës për Rikthim të Aseteve, me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe këshillave për prokurorët e shtetit si dhe partnerët ndërkombëtarë në rastet e rikthimit të asetëve dhe bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtarë.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë nga Ambasada e SHBA-së, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Zyra e BE-së dhe Zyra e UNDP-së në Kosovë.

### **U.D. Kryeprokurori i Shtetit kërkon nga kryeprokurorët efikasitet më të lartë në trajtimin e rasteve të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara**

**Prishtinë, 30 korrik 2024** – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjin e rregullt me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit, përfaqësues të prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë.

U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka diskutuar për raportet e prokurorive të vendit lidhur me rezultatet e prokurorëve për rastet që kanë të bëjnë me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara të cilat janë përdorur për kryerjen e veprave të ndryshme penale apo janë përfituar nga vepra penale, e të cilat gjenden në depon e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK).



Lidhur me këtë, U.D. Kryeprokurori i Shtetit ka kërkuar nga kryeprokurorët e prokurorive

efikasitet më të lartë në trajtimin e këtyre rasteve në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjeve tjera në fuqi, ku në mes tjerash është parashikuar edhe mundësia e shitjes së automjeteve të sekuestruara dhe të konfiskuara apo edhe e shfrytëzimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, krejt kjo me qëllim të parandalimit të pasojave që mund t'i bëhen buxhetit të shtetit për shkak të mos veprimit adekuat të prokurorëve.



Po ashtu në takim u diskutua edhe mundësia e pjesëmarrjes së prokurorëve të shtetit në trajnimet e Akademisë së Drejtës Evropiane (ERA), si dhe çështje të tjera profesionale.

### **Diskutohet bashkëpunimi ndërmjet Zyrës për Rikthim të Aseteve dhe Eulex-it**

**Prishtinë, 30 korrik 2024** – Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve (ZRA), prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Bahri Hyseni, priti në takim Monitoruesin Tematik të Eulex-it për Veprat Penale të Korrupsionit, z. Albert Effendi Van Nunen Karioen.

Temë kryesore e këtij takimi ndërmjet Udhëheqësit të ZRA-së dhe Monitoruesit të Eulex-it ishte diskutimi dhe informimi për detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Rikthim të Aseteve si dhe bashkërendimi i punës me akterët ligjzbatues dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Në anën tjetër, z. Karionen u zotua së është i gatshëm të ndihmojë dhe të japë kontributin e tij në dhënien e këshillave dhe gjetjen e praktikave më të mira për funksionimin sa më efikas të Zyrës për

Rikthimin e Aseteve e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

